

POLITIKAT NË FOKUS: FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

Në vitin 2016, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka filluar publikimin e dokumentit 'Politikat në Fokus' – i cili ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike. Më tutje, ky dokument gjithashtu ka për qëllim të përmbledhë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla në mënyrë që të hapet rruga drejt adresimit të tyre. Ky dokument publikohet në baza dy-mujore. Përderisa ky edicion vë fokusin në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, edicionet e ardhshme do të jenë mbi politika të tjera me interes për sektorin privat. Deri tani, Oda Amerikane ka publikuar dokumente të tilla mbi temat në vijim: Tregtia, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Politikat e Punësimit dhe Zbatimi i Kontratave.

Fokusi në Fondin për Garanci Kreditore

Qasja në financa vazhdimisht është identifikuar si një ndër sfidat kryesore me të cilën ballafaqohen ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në vend, duke ngadalësuar kështu zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Përderisa në të kaluarën shumica e shqetësimeve mbi këtë temë kishin të bënin me kushtet jo të favorshme të financimit nga institucionet e përfshira në këtë fushë, me kënaqësi theksojmë se mund të vërehen përmirësime të mesha në këtë aspekt gjatë viteve të fundit në vendin tonë.

Fillimi i punës së përmbaruesve privat dhe reformat e tjera në sistemin gjyqësor dhe zbatimin e kontratave, kanë kontribuar në uljen e rrezikut për kreditorët, gjë që ka

mundësuar uljen e normave të interesit. Figura 1 paraqet ndryshimin e normave të interesit gjatë dy viteve të fundit.

Për më shumë, Raporti i të Bërit Biznes i Bankës Botërore, rangon Kosovën në vendin

Norma efektive e interesit për korporatat jo-finaniare




Figura 1 Normat efektive të interesit

e 20 nga gjithsej 190 shtete në indikatorin përkatës për Marrjen e Kredive për vitin 2017 (World Bank Group, 2016).

Përderisa ka ende hapësirë për përmirësime që të adresohet rreziku i kreditimit në banka dhe institucione tjera financiare, trendi i përgjithshëm është inkurajues për sektorin privat, veçanërisht për ato kompani që mund të mbështesin aplikimet e tyre për kredi me asete të tyre.

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm e NMVM-ve në të kaluarën kanë hasur në vështirësi për të pasur qasje në financa si rezultat i mungesës së aseteve për të shërbyer si kolateral në aplikimet e tyre. Një gjë e fillë ka ndodhur veçanërisht tek

ndërmarrjet e reja dhe tek femrat ndërmarrëse, gjë që ka kufizuar mundësitë e tyre për rritje. Çështja e mungesës së kolateralit nuk është një dukuri vetëm në Kosovë, meqenëse një numër i madh i ekonomive në gjithë botën ballafaqohen me sfida të ngjashme.

Në një studim të Odës Amerikane në vitin 2014 që ka përfshirë një anketë me rreth 650 biznese, shumica e respondentëve (mbi 70%) kanë theksuar se kursimet personale dhe huazimet nga familjarët dhe miqtë janë burimi i tyre kryesor i financimit (Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, 2014). Përderisa përdorimi i kursimeve për qëllime të financimit mund të ketë përparësitë e veta, qasja në kapital nga institucionet financiare patjetër se mund të ndikojë në rritje më të theksuar të kompanisë.

Që të adresohet kjo çështje, Qeveria me ndihmën e organizatave donatore, veçanërisht USAID, ka filluar procedurat për krijimin e një fondi për garantimin e kredive. Kjo iniciativë është zbatuar gjatë këtij viti, dhe ndikimet e saj pritet të shihen gjatë viteve në vijim. Qëllimi i këtij dokumenti është që të paraqesë një përmbledhje mbi këtë Fond dhe të sqarojë se si bizneset mund të përfitojnë nga ai.

Themelimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Parlamenti i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në dhjetor 2015, i cili është publikuar në gazetën zyrtare në janar 2016. Ligji themelon fondin dhe vendos dispozitat për funksionimin, kompetencat, strukturën dhe procedurat për lëshimin e garancive kreditore. FKGK mbështetet nga programi i USAID "Fuqizimi i Mbështetjes së Kredive", program ky që planifikohet të zgjasë deri në vitin 2017 dhe që ka për synim të adresojë çështjen e qasjes në financa për MNVM-të në Kosovë.

Siç theksohet në nenin 10 të ligjit, FKGK është entitet juridik i pavarur, i cili do t'i raportojë

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Dy organet kryesore të Fondit janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues.

Sipas nenit 16, Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, 3 nga të cilët janë anëtarë *ex-officio*, ndërsa 4 anëtarët e tjerë zgjedhen nga donatorët. Anëtarët e Bordit kanë mandat 4 vjeçar. Mes

Neni 10 Themelimi dhe Forma e Organizimit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

FKGK-ja është entitet juridik i pavarur, autonom, i themeluar me këtë Ligj, me personalitet të plotë juridik, një entitet juridik i ndarë dhe i ndryshëm nga Bordi i Drejtorëve dhe Drejtuesit e FKGK. Pa kufizime për veprimet e ardhshme, FKGK ka të drejtë të lidhë kontrata, të padis dhe të paditet në emër të tij, të ketë në pronësi asetet e tij si dhe të pranojë grante apo donacione për të arritur objektivat e veta, duke përfshirë vecanërisht Kapitalin e Fondit sic specifikohet në këtë Ligj.

tjërash, përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve përfshijnë emërimin e Drejtorit Menaxhues, miratimin e regjistrimeve të Institucioneve Financiare, dhe miratimin për hyrjen në Marrëveshje të Garancisë me institucionet e regjistruara financiare.

Në anën tjetër, Drejtori Menaxhues i FKGK, që në të njëjtën kohë është anëtarë votues i bordit, do të shërbejë si kryeshef ekzekutiv i fondit me orar të plotë.

Synimet e FKGK

Disa nga synimet të cilat Fondi Kosovar për Garanci Kreditore synon t'i arrijë janë:

- Rritja e kredithënies për NMVM-të në Kosovë nga institucionet financiare vendore;
- Krijimi i vendeve të punës, rritja e prodhimtarisë lokale dhe shërbimet me vlerë të shtuar, përmirësimi i bilancit tregtar, zgjerimi i bazës tatimore, përforsimi i rjetit të sigurisë sociale, si dhe zvogëlimi i varfërisë;

- Mundësi më të mira për sektorët dhe kategoritë e cënueshme ekonomike dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rininë;
- Kontributi në çlirimin dhe mobilizimin e afro 600 milionë Eurove nga likuiditeti i tepërt në banka, për të vepruar si katalizator i rritjes së biznesit dhe punësimit; si dhe
- Mundësimi që IMF-të dhe IFJB-të të zvogëlojnë riskun e tyre, si dhe ndihma në rritjen e numrit të mikro-bizneseve dhe bizneseve të vogla të "kreditueshme" (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, 2016)

Përqindja e garancisë

Ligji përcakton që përqindja e garancisë nënkupton "përqindja e kryegjësë së papaguar e Kredisë që mbulohet me Garancinë Kreditore, specifikuar nga institucioni i regjistruar financiar kur dorëzohet Kredia tek FKGK-ja për Garanci Kreditore, që nuk tejkalon 50% të kryegjësë së papaguar" (Parlamenti i Republikës së Kosovës, 2016). Kjo do të thotë se nëse një kredi përmbush kushtet për t'u garantuar në përputhje me këtë ligj, bizneset prap se prap duhet të jenë në gjendje të mbulojnë 50% e kryegjësë së mbetur. Një gjë e tillë sigurisht se është bërë për t'u ndarë rreziku me biznesin në mënyrë që të evitohet huamarrja e papërgjegjshme dhe sjellje të tilla të ngjashme nga huamarrësit.

Parimi i Plotësueshmërisë

Një ndër parimet kryesore të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore është "plotësueshmëria". Kjo do të thotë që Fondi do të ofrojë mbulesë vetëm për kreditë të cilat banka nuk do t'i lëshonte përndryshe. "FKGK do të arrijë këtë plotësueshmëri duke nxitur kredi të reja për grupet e shënjestruara, gjë që çon drejt një shifre me rritje të konsiderueshme të kredive të reja, parave në ekonomi, si dhe krijim të vendeve të punës" (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, 2016).

Pra, kjo do të arrihet për faktin se institucionet financiare do të jenë në gjendje të lëshojnë kredi bizneseve që nuk kanë sa duhet kolateral, dhe që në kushte normale nuk do t'u lëshohet kredia.

Kualifikimi i kredive dhe i bizneseve

Ekzistojnë një numër i kriterëve që duhet të mbushen në mënyrë që një kredi të kualifikohet për garanci kreditore nga ky fond. Këto kushte janë të specifikuar në Nenin 6 të Ligjit.

Neni 6

Aplikimi dhe kualifikimi i kredive për mbulim me garanci

1. Për kualifikimin e një kredie për garanci kreditore, duhen përmbushur kushtet minimale vijuese;

- 1.1. kredia duhet të jetë për një NMVM të kualifikuar;
- 1.2. kredia duhet të jetë për financime të reja, si dhe nuk mund të jetë për ripërtëritje, ristrukturim apo riatëzim të një kredie, lizingu apo ndonjë financim tjetër ekzistues apo paraprak;
- 1.3. kredia duhet të jetë për qëllime të ligjshme, si dhe për shtytjen e rritjes dhe qëndrueshmërisë së NMVM-së;

Pra, një aspekt që vlen të theksohet është që ripërtëritja apo ristrukturimi i kredive nuk kualifikohet për t'u mbështetur nga FKGK. Fondi do të mbështesë vetëm financime të reja që përmbushin kriteret e caktuara në nenin 6. Pë më shumë, bizneset që kanë mbi 250 punëtorë nuk kualifikohen për të përfituar nga kjo skemë. Sipas faqes zyrtare të FKGK, disa parametrat për NMVM-të e kualifikuara për t'u mbështetur nga fondit janë:

- NMVM-të që janë të qëndrueshme, por nuk kanë kolateralin dhe/ose historinë e duhur kreditore;
- NMVM-të që kanë nevojë për financim afatgjatë;
- NMVM-të që mund të rrisin prodhimin vendor dhe të zvogëlojnë importet dhe/ose të rrisin eksportet;
- NMVM-të në pronësi të grave, komuniteteve jo-shumicë dhe ndërmarrësve;

- NMVM-të që do të krijojnë vende të reja të punës (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, 2016)

Si mund të përfitojnë bizneset?

Një gjë shumë e rëndësishme të theksohet është se **bizneset nuk mundën (dhe nuk kanë nevojë)** të aplikojnë për garancion tek FKGK apo tek institucioni financiar i përzgjedhur nga ta. Nëse një kompani paraqet një aplikacion për kredi dhe institucioni financiar pas analizës kreditore vlerëson se kredia duhet të lëshohet, mirëpo biznesi në fjalë nuk ka kolateral të mjaftueshëm, atëherë institucioni i regjistruar financiar und të dërgojë kredinë në FKGK për t'u garantuar, varësisht se a kualifikohet ajo kredi sipas ligjit. Prandaj, bizneset nuk mund të fillojnë asnjë procedurë në këtë aspekt, por do të përfitojnë në rast se parakushtet e sqaruara në këtë dokument plotësohen.

Aspekte procedurale

Institucionet financiare që licencohen dhe mbikëqyren nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, që dëshirojnë të përfitojnë nga ky fond, fillimisht duhet të **aplikojnë për regjistrim në FKGK**. Pas shqyrtimit të aplikacionit të tyre, FKGK merr vendim se a i përmbush apo jo ai institucion financiar kriteret për regjistrim.

Në rast se përgjigja është pozitive, FKGK hyn në Marrëveshje Garancie me atë institucion "duke specifikuar mbulimin, kufizimet, politikat dhe procedurat në fuqi për garantimin e kredive, duke i paguar


provizionet për FKGK-në dhe për institucionet e regjistruara financiare që parashtrojnë kërkesë tek FKGK-ja për Rastet e Garantuara si dhe çështje të caktuara që mund të specifikohen me Statutin dhe Politikat e Procedurave të Brendshme" (Parlamenti i Republikës së Kosovës, 2016). Më pastaj, bazuar në marrëveshje FKGK do të lëshoj garanci kreditore për institucionin financiar nv fjalë. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës tanimë ka hartuar një Rregullore që specifikon informatat dhe dispozitat që një Marrëveshje Garancie duhet t'i ketë.

Institucionet financiare që kualifikohen për t'u regjistruar me FKGK përfshijnë bankat, institucionet financiare jobankare, dhe institucionet mikro-financiare. Një numër i konsiderueshëm i institucioneve financiare tanimë kanë arritur marrëveshje me Fondin. Sipas faqes zyrtare të FKGK, 4 banka komerciale deri tani kanë kompletuar këtë procedurë.

Nëse garancioni aktivizohet, FKGK do të kompensojë institucionin financiar shumë e garantuar, pasi pretendimet të miratohen dhe vërtetohen.

Financimi dhe Investimet

Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria financiare, institucionet financiare duhet të paguajnë tarifa të garancisë për garancitë kreditore, dhe rrjedhimisht në baza vjetore për shumë e garantuar deri kur rasti i garantuar ndodh. Neni 8 i ligjit qartëson se tarifat përdoren për qëllim të mbulimit të



shpenzimeve operative dhe për të mbuluar humbjet eventuale kreditore, përdërisa shuma tepruar mbet në FKGK për të rritur qëndrueshmërinë e tij.

Megjithatë, financimi i FKGK është më i gjerë dhe përfshinë elementet në vijim: (kapitali i Fondit i dhuruar nga Qeveria e Republikë së Kosovës dhe donatorët, në formë të grantit, (2) tarifata e Garancisë që paguhen nga Institucionet e regjistruara financiare për Garancitë Kreditore, (3) interesi dhe të ardhurat e investimeve nga depozitimet dhe investimet e Kapitalit të Fondit dhe asetete tjera të FKGK, (4) kontribute tjera kapitale, përfshirë kapital shtesë të dhuruar që mund të pranohet; (5) huamarrja, duke përjashtuar huamarrjen nga Institucionet e Regjistruara Financiare (Parlamenti i Republikës së Kosovës, 2016).

Në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria dhe të ruajtur likuiditetin e Fondit, FKGK do të investojë mjetet në përputhje me politika të investimeve që aprovohen nga Bordi i Drejtorëve. Siç parashihet në ligj, fondet do të investohen në instrumente "më të sigurta", që përfshijnë:

- *depozita të euros ose instrumente në BQK*
- *bono të thesarit dhe Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës*
- *depozita të euros ose instrumente me bankat që janë Institucione të Regjistruara Financiare, të licencuara dhe që operojnë në Kosovë,*
- *depozita të euros dhe jo-euros apo instrumente me Bankën Qendore Evropiane dhe Bankat tjera të Bashkimit Evropian nga shtetet anëtare të cilat, në kohën e investimit, janë të klasifikuara si Primare apo me Shkallë të Lartë nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit*
- *depozita të euros dhe jo-euros apo instrumente të lëshuara nga shtetit apo bankat komerciale të licencuara si të*

tilla në vendet e përcaktuara në paragrafin paraparak dhe të cilat po ashtu janë të klasifikuara individualisht si të Larta (a) nga klasifikimi Fitch, apo ndonjë klasifikim ekuivalent;

Për më shumë, Neni 25 i Ligjit thekson se Fondi do të veprojë në përputhje me mekanizmat e parapara raportuese dhe të mbikëqyrjes sipas ligjit dhe akteve tjera juridike. FKGK do të dorëzojë BQK-së raportin vjetor të audituar SNRF, dhe do t'i japë raporte të rregullta periodike BQK-së sa i përket portfolios së garancive dhe analizën e rrezikut për atë portfolio. Në anën tjetër, sipas nenit 25, BQK detyrohet që të lëshojë rregullore sa i përket peshimit të rrezikut dhe kërkesave për rezerva për institucionet financiare sa i përket pjesës së kredive të garantuara nga FKGK.

Shembuj të Mekanizmave për Garanci Kreditore në Botë

Përdërisa mekanizmi për garanci kreditore është risi në Kosovë, padyshim se një gjë e tillë nuk qëndron për një numër të madh të shteteve. Mekanizma të tillë përdoren në masë të konsiderueshme nga shtetet e ndryshme për të adresuar çështjen e mungesës së kolateralit dhe qasjes së kufizuar në financa, veçanërisht për MNVM-të. Këto mekanizma dallojnë nga njëra tjetra në aspekt të strukturës/kornizës ligjore, strukturës së pronësisë, përqindjes së mbulueshmërisë së garancionit, strukturës së vendimmarjes, llojeve të shërbimeve të ofruara etj. Paragrafët vijues japin shembuj dhe sqarime të shkurta për disa nga këto dallime.

Korniza dhe Struktura ligjore

Duke pasur në konsideratë një numër të madh të mekanizmave për garanci kreditore në nivel botëror, struktura ligjore padyshim se ndryshon. Në shumicën e vendeve, Fondet për Garanci Kreditore janë organizata jofitimprurëse, që janë subjekt i sistemeve rregullative të veçanta (OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013). Në shumicën e rasteve,

funkcioni i kontrollit mbi këto fonde i caktohet qeverisë përmes ndonjë ministrie relevante, apo Bankës Qendrore si organ rregullativ. Kjo gjithashtu varet edhe nga struktura ligjore e fondit (publik, privat, apo kombinim i të dyjave).

Në një numër të vendeve, siç është rasti në Gjermani, "ka edhe lehtësira tatimore për të nxitur aktivitetin e garantimit të kredive"(OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013). Megjithatë, në këtë rast mekanizmi për garantimin e kredive është bankë komerciale private që licencohet për të ofruar vetëm shërbimin e garancive. Pasja e stimujve tatimor nxit bankën që të ri-investojë fitimet e realizuara nga aktivitetet e tyre.

Struktura e Pronësisë

Mekanizmat për Garanci Kreditore ndryshojnë edhe sa i përket strukturës pronësore, varësisht nevojave të tregut dhe kornizës ligjore ekzistuese në vend. Në përgjithësi, ekzistojnë tri lloje të fondeve për garantim të kredive:

- *Mekanizmat Publik të Garancioneve;*
- *Mekanizmat Publiko-Privat të Garancioneve;*
- *Mekanizmat Privat të Garancioneve (OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013)*

Mekanizmat në pronësi publike themelohen me financim të qeverive përkatëse zakonisht në ekonomitë në zhvillim për të përmirësuar qasjen në financa për MNMV-të lokale. Përpos shteteve si India, Indonesia, Kanada etj, fondet e tilla mund të gjenden edhe në vende evropiane (Austri, Slloveni, Itali, Greqi, Belgjikë etj.). Në mekanizma të këtij lloji, përdërisa qeveria financon fondin, në shumicën e rasteve vendimmarrja sa i përket vlerësimit të riskut dhe aprovimi i garancive i lihet sektorit privat.

Në mekanizmat e kombinuara të garancive, financimi i fondit bëhet nga sektori publik dhe privat. Në raste të tilla, një organ

shtetëror (siç është rasti i Organizatës për Zhvillimin dhe Përkrahjen e NVM-ve në Turqi) kryen shumicën e financimit (dhe rrjedhimisht është aksionari më i madh), ndërsa sektori privat kontribuon zakonisht përmes shoqatave biznesore, ose përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të bankave komerciale. Megjithatë, ka përjashtime, siç është rasti në Portugal ku Sistemi i Përbashkët i Garancive u nis nga qeveria dhe gradualisht i gjithë menaxhimi dhe shumica e aksioneve iu kaluan sektorit privat (OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013).

Mes mekanizmave më të vjetra të garantimit janë ato të nisura dhe menaxhuara nga sektori privat në tërësi, përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të huamarrësve që tentojnë të krijojnë kushte më të mira të financimit për veten e tyre. Në raste të tilla, roli i qeverisë mbetet vetëm ai rregullativ, dhe rrallëherë edhe i financuesit. Në këto "Skema të Përbashkëta të Garancive", vlerësimet e kredive bëhen nga vetë fondit, duke pasur parasysh se kanë njohuri të detajuara për ambientin afarist lokal. Procesi i shqyrtimit nga njerëz të fushës (peer review) mundëson vlerësim të duhur të riskut dhe shmang rrezikun e sjelljeve të papërgjegjshme të huamarrësve. (OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013).

Përqindja e garantimit

Fondet për Garanci Kreditore dallojnë nga njëra tjetra edhe sa i përket përqindjes së garancisë, si mekanizëm për të ulur riskun. Sipas një raporti të OECD, mediana sa i përket kësaj përqindjeje në mesin e 76 shteteve është 80%, që njëkohësisht paraqet edhe limitin e sipërm të garantimit sipas Kornizës së Bashkimit Evropian për Ndihmën Shtetërore. Në raste të caktuara, Fondet mund të përdorin përqindje të ndryshme të mbulueshmërisë për të synuar audiencë të caktuar. Për shembull, Fondi për Garanci Kreditore në Kosta Rika ofron përqindje më të lartë të garancive për gratë ndërmarre në

zonat rurale të shtetit. Në raste tjera, kjo përqindje mund të ndryshojë varësisht nga maturiteti i kredisë së kërkuar: afatshkurtër apo afatgjatë (OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development, 2013).

Shërbimet e ofruara

Përveç shërbimit parësor të ofrimit të garancive kreditore, mekanizmat e tillë ofrojnë edhe shërbime shtesë për komunitetin e biznesit në të cilën ato ushtrojnë veprimtarinë. Meqenëse një gjë e tillë mund të ndodh në Kosovë në të ardhmen, kjo për shkak se Neni 9 i ligjit e lejon një gjë të tillë, është me interes të shikohen shembuj të tillë nga vendet e tjera.

Një numër i Fondeve për Garanci Kreditore ofrojnë asistencë në përgatitjen e raporteve financiare në përputhje me standardet financiare të aplikueshme të atë treg. Fonde tjera i ndihmojnë MNMV-të në çështje biznese, duke i asistuar ato në rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Në disa vende, siç është rasti i Gjermanisë dhe Finlandës, fondet ofrojnë Garanci Kreditore për eksporte, në mënyrë që të mbrohen huamarrësit nga mospagesa e importuesve në tregun e huaj. Skemat si kjo ndihmojnë jo vetëm huamarrësin, por edhe përmirësojnë perspektivat e vendit në skenën e tregtisë ndërkombëtare.

Të tjera

Mekanizmat për Garanci Kreditore ndryshojnë edhe në disa mënyra tjera. Për shembull, ato ndryshojnë sa i përket kriterëve për kompanitë e kualifikuara. Përderisa shumë vende kanë kufizime sa i përket madhësisë së kompanive (qarkullimi, numri i punëtorëve etj.), shtete tjera kanë kufizime sa i përket industrisë, vendndodhjes gjeografike dhe të tjera. Disa vende ndjekin politika për të stimuluar zhvillimin e rajoneve të caktuara të territoreve të tyre, dhe mekanizmat për garanci kreditore mund të ndihmojnë në këtë aspekt gjithashtu.

Procesi i vendimmarrjes dhe vlerësimit të rrezikut për garanci kreditore ndryshon nga njëri fond në tjetrin. Megjithatë, në shumicën e rasteve kjo kompetencë iu transferohet institucioneve financiare të regjistruara, meqenëse ato e kanë ekspertizën për aktivitete të tilla. Financimi i Fondeve për Garanci Kreditore është gjithashtu një element i ndryshueshëm nga rasti në rast.

Hapat e mëtejshëm

Ashtu siç është sqaruar në dokument, mekanizmi për garanci kreditore është i ri në Kosovë, dhe rrjedhimisht është shumë herët për të matur suksesin e tij. Ligji dhe aktet përcjellëse nënligjore janë miratuar në vitin 2016 dhe marrëveshjet e para mes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe institucioneve financiare janë finalizuar në muajt e fundit. Mbetet të shihet se a do të ketë ndikimin e pritur ky mekanizëm në aspekt të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë. Megjithatë, ky hap është mbështetur në vazhdimësi nga sektori privat në vend.

Si përmbledhje, bizneset nuk kanë nevojë për të aplikuar për garantim të kredisë në FKGK. I mbetet institucioneve financiare tek të cilat ata kanë aplikuar të bëjnë një gjë të tillë, nëse vlerësohet se aplikuesi i përbush kushtet për marrjen e kredisë mirëpo nuk ka kolateral të mjaftueshëm që t'i aprovohet ajo kredi.

Për fund, politikëbërësit duhet të shikojnë shembujt nga shtete të ndryshme për të analizuar mundësinë e zgjerimit të llojeve të garancive kreditore për të ofruar në sektorin privat. Me interes për sektorin e prodhimit do të ishte mekanizmi për garantimin e kredive të eksportit, një skemë kjo e përdorur nga Fondet Finlandeze dhe Gjermane për Garanci Kreditore.

Lista e shkurtesave

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

IMF – Institucionet mikrofinanciare

NMVM – Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

IFJB – Institucionet Financiare Jo-bankare

OECD – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

Referencat

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. (2016). *Synimet Kryesore*.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. (2014, Qershor). Gjendja e Biznesit në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë e të Bërit Biznes në Kosovë. Prishtinë: Oda Amerikane.

OECD Centre for Entrepreneurship, SMEs and Local Development. (2013, January 30). SME and Entrepreneurship Financing: The Role of Credit Guarantee Schemes and Mutual Guarantee. Organisation for Economic Co-operation and Development. Gjetur në

Parlamenti i Republikës së Kosovës. (2016, Janar). Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Prishtinë.

World Bank Group. (2016, Tetor 25). Doing Business 2017- Equal Opportunity for All. Washington, United States of America: International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.